



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr. 928/2019

kundër

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

lidhur me harmonizimin e Rregullores (MKRS) nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve me Rregulloren (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore

Drejtuar: Znj. Vlora Dumoshi, ministre
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Sheshi “Nëna Terezë”, p.n.
10000 Prishtinë

Z. Iber Alaj, u. d. sekretar i përgjithshëm
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Sheshi “Nëna Terezë”, p.n.
10000 Prishtinë

Prishtinë, më 12 shkurt 2021

Qëllimi i raportit

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejshëm: MKRS), lidhur me mospërputhjen e Rregullores nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ansambllit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve, e miratuar nga MKRS-ja më 21 gusht 2019, me Rregulloren nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 25 shtator 2018.

Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
3. Gjithashtu, edhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, me përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 16, paragrafi 1, dhe me nenin 18, paragrafët 1, 2, 4, 5, 6 dhe 8.

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t'i kryejë përgjegjësitë e lartcekura kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i çështjes

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Avokati i Popullit, të cilat ia ka ofruar ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, kishte pranuar ankesë nga z. Naim Berisha, nënkryetar i Shoqatës Sindikale të Teatrit Kombëtar të Kosovës, parashtruar kundër Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me miratimin e Rregullores nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ansambllit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve.
5. Ankuesi pretendon se kjo rregullore është në kundërshtim me rregulloren e Qeverisë - Rregullorja (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore. Po ashtu, ankuesi pretendon se Rregullorja nr. 04/2019 nuk ua njeh aktorëve rolet e luajtura në teatrot e tjera publike të qyteteve. Ankuesi njofton se më 4 shtator 2019, ka paraqitur Ankesë nr. 3744/2019 në MKRS, mirëpo nuk ka marrë përgjigje.
6. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, më 30 mars dhe më 9 qershor 2020, i ka dërguar shkresë MKRS-së dhe ka kërkuar informacione nëse MKRS-ja ka informata për Ankesën nr. 3744/2019, e paraqitur më 4 shtator, si dhe nëse është marrë ndonjë veprim me qëllim që ankuesit t'i kthehet përgjigje lidhur me ankesën e paraqitur.
7. Më 25 qershor 2020, MKRS-ja ka kthyer përgjigje dhe ka njoftuar se sa i përket Rregullores nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ansambllit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve, ky akt nënligjor është pjesë e programit legjislativ të akteve nënligjore për vitin 2020 dhe shumë shpejt do të formojnë ekipin punues, i cila do ta plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren nr. 04/2019 dhe do të shqyrtohet nëse rregullorja është në harmoni me aktet e tjera relevante.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë

8. Ligji nr. 04/L-106 për Teatrot, neni 16, paragrafi 8, përcakton mundësinë e nxjerrjes së aktit nënligjor me qëllim të rregullimit të çështjes së organizimit, funksionimit, kategorizimit dhe kohëzgjatjes së angazhimit në ansamblin artistik: “*Organizimi, funksionimi, kategorizimi dhe kohëzgjatja e angazhimit në ansamblin artistik rezident rregullohet me akt nënligjor.*”
9. Rregullorja e Qeverisë nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore, neni 6 [*Kriteret e gradimit*], përcakton:

Neni 6

Kriteret e gradimit

1. *Gradimi i krijuesve dhe përformuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, bëhet sipas këtyre kriterëve:*

- 1.1. *Kualifikimi dhe përgatitja profesionale;*
- 1.2. *Përvoja profesionale e punës;*
- 1.3. *Performanca;*
- 1.4. *Shkalla e përgjegjësisë në punë;*
- 1.5. *Rezultatet e arritura në fushën përkatëse.”*

10. Rregullorja nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve, neni 8 [*Kategorizimi i aktorëve*], përcakton:

Neni 8

Kategorizimi i aktorëve

Aktorët e ansamblit rezident kategorizohen në:

1. *Aktorët e kategorisë së parë – të parët e Teatrit:*

1.1. *Në kategorinë aktorët e kategorisë së parë – të parët e teatrit bëjnë pjesë aktorët e spikatur (të mirënjohur), që me angazhimin e tyre janë bartës të repertorit, nga puna e të cilëve varet afirmimi i suksesit krijues të teatrit. Në këtë kategori hyjnë aktorët, të cilët në produksionet apo koproduksionet e teatrit, në të cilin janë punësuar si anëtarë të rregullt të ansamblit rezident (apo teatrove simotra), kanë realizuar më së paku 15 (pesëmbëdhjetë) role në kuadër të repertorit të rregullt, nga të cilat së paku 7 (shtatë) janë role kryesore.*

2. *Aktorët e kategorisë së dytë – të dytët e teatrit:*

1.2. *Në kategorinë aktorët e kategorisë së dytë – të dytët e teatrit bëjnë pjesë aktorët të cilët me përvojën, angazhimin, talentin dhe aftësitë e tyre krijuese kontribuojnë në promovimin e suksesit krijues të teatrit. Në këtë kategori hyjnë aktorët, të cilët në produksionet apo koproduksionet e teatrit në të cilin janë punësuar si anëtarë të rregullt të ansamblit rezident (apo teatrove simotra), kanë realizuar së paku 10 (dhjetë)*

role në kuadër të repertorit të rregullt, nga të cilat së paku 3 (tre) rol është kryesor dhe 7 (shtatë) dytësore;

3. Trupa rezidente:

1.3. Në kategorinë trupa rezidente bëjnë pjesë aktorët të cilët janë vlerësuar për përvojën, angazhimin, talentin dhe aftësitë e tyre krijuese. Aktori i kategorisë trupa rezidente është aktori i sapo punësuar në teatrin amë apo aktori i cili nuk i plotëson ende kriteret e dy kategorive të para.”

Analiza e rastit

11. Avokati i Popullit vëren se Rregullorja nr. 15/2018 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 25 shtator 2018, ndërsa Rregullorja nr. 04/2018 është miratuar nga MKRS-ja më 21 gusht 2019. Vërehet se për nga aspekti kohor, Rregullorja nr. 15/2018 është miratuar më herët se Rregullorja nr. 04/2018. Në anën tjetër, në kuptimin hierarkik, aktet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës i dominojnë aktet e miratuara nga ministritë.
12. Sa i përket neneve të theksuara më sipër, Avokati i Popullit thekson se Rregullorja nr. 04/2019, në nenin 8 [Kategorizimi i aktorëve], përmban mënyrat e kategorizimit të aktorëve, ndërsa Rregullorja nr. 15/2018, përkatësisht neni 6 [Kriteret e gradimit], ka përcaktuar qartë kriteret e gradimit.
13. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur se në nenin 8 të Rregullores nr. 04/2019, si përvojë pune njihet vetëm përvoja e aktorëve, të cilët janë punësuar si anëtarë të rregullt të ansamblit rezident apo të teatrove simotra, mirëpo nuk përcaktohen kriteret e tjera sipas të cilave mund të kategorizohen aktorët. Në këtë rast, sipas përmbajtjes së dispozitës në fjalë, është e paqartë se a merret parasysh përvoja e realizuar në teatrot e qytetit, si kriter për kategorizimin e aktorëve.
14. Avokati i Popullit konsideron se një normë për t’u zbatuar me sukses duhet të jetë e qartë, e veçanërisht normat të cilat përmbajnë kriteret e gradimit ose të kategorizimit të subjekteve të caktuara.
15. Në rastin konkret, Avokati i Popullit thekson se kriteret e gradimit të përcaktuara në nenin 6 të Rregullores nr. 15/2018 do duhej të përfshiheshin në tërësi në nenin 8 të Rregullores nr. 04/2018 të MKRS-së.
16. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative përcakton:
Neni 6 [Parimet e përgjithshme të hartimit të akteve normative], paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.7 përcaktojnë:
1.1 Teksti i një akti duhet të jetë i qartë, i thjeshtë, konciz dhe mos të jetë i dykuptimtë, shkurtesat e panevojshme, zhargonet dhe fjalitë e gjata duhet të shmangen.
1.7 Duhet të shmanget jo përputhshmëria me legjislacionin ekzistues, si dhe përsëritja e panevojshme e dispozitave ekzistuese.
17. Avokati i Popullit konsideron se mangësitë në aktet normative ndikojnë në sundimin e ligjit, përkatësisht në sigurinë juridike. Me sigurinë juridike kërkohet që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize, me të cilat synohet parashikimi i situatave dhe veprimet ose

premtimet e dhëna individëve nga shteti (pritjet legjitime) duhet të respektohen. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji duhet të zbatohet në praktikë.¹

18. Prandaj, duke pasur i parasysh rrethanat e theksuara më sipër dhe me qëllim të harmonizimit dhe eliminimit të paqartësive në përmbajtjen e akteve normative, Avokati i Popullit i:

REKOMANDON

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Ta ndryshojë dhe ta plotësojë Rregulloren nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve, përkatësisht neni 8 i kësaj rregulloreje të harmonizohet me nenin 6 të Rregullores (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

¹ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)
REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session (Venice, 25-26 March 2011) (44-51); Po ashtu shih Raportin me Rekomandime të Avokatit të Popullit A.nr: 201/2015 Behram Krasniqi kundër Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, apo të internuarit të UÇK-së <https://www.oik-rks.org/2015/10/26/raport-me-rekomandime-2012015-lidhur-me-zbatimin-e-nenit-8-paragrafi-2-te-ligjit-nr-04-l-054/>